

VENDIM
Nr.246, datë 11.4.2007

**PËR NJË SHITESË FONDI, PËR ZBATIMIN E SISTEMIT TË AUTOMATIZUAR NË
DOGANË “ASYCUDA WORLD”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 12 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, në buxhetin e miratuar për vitin 2007, zëri “Investime” t’i shtohet fondi 110 (njëqind e dhjetë) milionë lekë, për modernizimin dhe migrimin e sistemit të automatizuar të procedurave doganore ASYCUDA ++në ASYCUDAWORLD, të zhvilluar nga konferenca e Kombeve të Bashkuara për tregti dhe zhvillim (UNCTAD).

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha